



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në bazë të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, neni 6 paragrafi 6.3 bie këtë:

VENDIM

I

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Bujar Shabani B.I., LUAN HARADINAJ SOL 1 HY.1 NR.4, -, PRISHTINË e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 05.11.2021 për aktivitetin e prokurimit me numër 626-21-7385-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-21-022-5-2-1 me titull “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale në Mamushë”

II

Vërtetohet vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës i datës 01.11.2021 me të cilin është shpërblyer me kontratë operatori ekonomik "SEFERI-CO" SH.P.K., Gjinoc-Suharekë.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Bujar Shabani B.I. me datë 05.11.2021 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale në Mamushë”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e grupit të O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1, 7, 59, 60, 64 dhe 69 të LPP-s. Të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e grupit të operatorëve ekonomik ankues është cekur se O.E. i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kapaciteti teknik e profesional pika 9.1 dhe 9.2 ku është kërkuar nga AK-ja: 2.4 Një (1) Inxhinier i infrastrukturës rrugore- Kërkohet që inxhinieri të ketë min. 3 vite përvojë pune – në angazhimet profesionale. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:

2. Listën origjinale të punëtorëve të O.E. të nënshkruar dhe vulosur nga O.E. -Diplomat e inxhinierëve (kopje të noterizuar. Diplomat jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara) -Cv-të e inxhinierëve të nënshkruar nga inxhinieri (origjinal ose kopje të noterizuar)

Sa i përket këtij pretendimi, konsiderojmë që O.E. i rekomanduar e ka plotësuar në tërësi kërkesën e lartcekur pasi që ka dorëzuar diplomën e Inxhinierit Armend Aliu i cili sipas diplomës të dorëzuar dhe CV-së shihet se ka mbaruar studimet në programin Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë, pasi që në kërkesën tonë si AK nuk kemi cekur se O.E. duhet të jetë inxhinier me sistem pesë vjeçar apo bachelor. Andaj ne si AK në bazë të nenit 59 të LPP-së paragrafi 4 jemi të detyruar që vlerësimin ta bëjmë në bazë të kërkesave të cilat i kemi paraqitur në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, pra nuk mund ti diskualifikojmë Operatorët Ekonomik për një kërkesë të cilën nuk e kemi paraparë në dosje të tenderit dhe njoftimin e kontratës.

Është e vërtetë se ne në bazë të kërkesës së komisionit vlerësues, kemi kërkuar sqarim nga O.E. i rekomanduar në lidhje me inxhinierin në fjalë, mirëpo pasi kemi marrë përgjigje se nuk është kërkuar inxhinier me kualifikim master por inxhinier me 3 vite përvojë pune, kemi vlerësuar se me të vërtetë nuk është cekur se inxhinieri duhet të jetë me sistem pesë vjeçar apo master. Andaj është konstatuar që O.E. i rekomanduar e ka plotësuar tërësisht këtë kusht pasi që ka dorëzuar dëshminë e përvojës së inxhinierit dhe të gjitha dokumentet e cekura më lartë. Sa i përket pretendimit se është favorizuar O.E. i rekomanduar ky pretendim nuk qëndron, pasi që kriteri për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Ne nuk kemi bërë kurrfarë favorizimi pasi që O.E. i rekomanduar ka paraqitur tenderin me çmimin më të ulët dhe i ka plotësuar të gjitha kërkesat e paraqitura në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Andaj konsiderojmë që pretendimi i O.E. ankues është i pa bazë.

Edhe sa i përket pretendimit të dytë në lidhje me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kapaciteti teknik e profesional neni 9.1 dhe 9.2 në pikën 3 ku është kërkuar nga AK-ja: **3. 3.1 O.E. duhet të caktoj me vendim ose të autorizoj menaxherin e kontratës për këtë projekt, i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv), të ketë së paku 10 vite përvojë pune. 3.2 Një udhëheqës të punishtes inxhinier ose bachelor i ndërtimtarisë. Si dëshmi për këtë kërkesë është kërkuar: 3. Autorizimi ose vendimi për caktimin e menaxherit të projektit (Origjinal ose Kopje të noterizuar) -Diplomat e inxhinierëve (kopje të noterizuar. Diplomat jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara) -Cv-të e inxhinierëve të nënshkruar nga inxhinieri (origjinal ose kopje të noterizuar)**

Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, me tenderin e tij ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara më lartë nga të cilat shihet se udhëheqëse të punishtes e ka caktuar znj. Donjetë Berisha e cila ka përfunduar studimet master në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë në Departamentin e Ndërtimtarisë në drejtimin (programin) e hidroteknikës. Sa i përket pretendimit të O.E ankues se inxhinierja në fjalë është e diplomuar në degën e hidroteknikës dhe jo në drejtimin e ndërtimtarisë, duhet të sqarojmë se drejtimi i hidroteknikës është drejtim në kuadër të Departamentit të Ndërtimtarisë në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë.

Sa i përket pretendimit se znj. Adelina Zenelaj ka marrë titullin bachelor i ndërtimtarisë dhe se për këtë fakt O.E. i rekomanduar për kontratë, nuk plotëson kërkesën 2.3 nga dëshmitë shihet se znj. Adelina Zenelaj nuk është caktuar në asnjë detyrë por O.E. vetëm e ka dorëzuar me tenderin e tij diplomën dhe CV-në e sajë. Ndërsa kërkesën në fjalë O.E. i rekomanduar e ka plotësuar duke ja

bashkangjitur dëshmitë për znj. Donjetë Berisha. Andaj konsiderojmë që pretendimi i O.E. ankues është i pa bazë.

Edhe pretendimi se nuk është respektuar kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së nuk qëndron, pasi që sikur është cekur më lartë O.E. i rekomanduar ka paraqitur tender të përgjegjshëm, meqenëse i ka plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë si dhe ka ofruar çmimin më të ulët në mesin e tenderuesve pjesëmarrës në këtë tender.

Sa i përket pretendimit se është shkelur dispozita e paraparë në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë pasi që ne të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi dhe procedurën e kemi udhëhequr në mënyrë transparente në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. O.E. ankues ka kërkuar qasje në dokumentet e tenderit në fjalë dhe ne kemi qenë transparent duke ia ofruar qasjen e pa penguar për të gjitha dokumentet të cilat i ka kërkuar. Nga procesverbali i qasjes në dokumentacionin e këtij tenderi shihet se përfaqësuesi i O.E. ankues nuk ka pasur asnjë vërejtje në lidhje me qasjen, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente.

Grupi i O.E. ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi respektuar të gjitha dispozitat ligjore të legjislacionit të Prokurimit Publik. Për tu siguruar që kjo procedurë të zhvillohet në mënyrën më efikase ne kemi shkurtuar afatin e dorëzimit të tenderit me qëllim që ky projekt të mos zvarritet si dhe të realizohet brenda këtij viti fiskal. Gjithashtu gjatë kësaj procedure, janë zbatuar të gjitha parimet e LPP-s dhe është marrë për bazë parimi i shfrytëzimit të drejtë të fondeve publike, duke u kujdesur që të marrim vlerën për parane, pasi që kemi shpërblyer tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët në mesin e tenderuesve pjesëmarrës në këtë tender.

Sa i përket dëmeve materiale për të cilat O.E. pretendon se i janë shkaktuar, në dosje të tenderit është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre. O.E. ankues ka paraqitur një shumë enorme të shpenzimeve me qëllim të përfitimit të pa bazë dhe të pa drejtë. Andaj konsiderojmë se edhe ky pretendim është i pa bazë.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 08.11.2021

Gazmend Grashi
Udhëheqës i sektorit të prokurimit
Komuna Mamushë



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi palë e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjet (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.